



Ambasada Britanike
Tiranë

MONITORIMI I KLD

PROMOVIMI DHE TRANSFERIMI I GJYQTARËVE, ZBATIMI I SISTEMIT TË PIKËZIMIT

NJE ANALIZE KRAHASUESE MES SISTEMIT TE VJETER DHE TE RI PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

TIRANE, 2011

I. Përshkrimi ligjor

Në Republikën e Shqipërisë rregullat për promovimin dhe transferimin e gjyqtarëve përcaktohen në aktet në vijim:

- ✚ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- ✚ Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- ✚ Ligji Nr. 9110, datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda”;
- ✚ Ligji nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, për aq sa nuk bie ndesh me Ligjin Nr. 9877/2008;
- ✚ Ligji nr. 8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✚ Vendimi nr. 227/2, datë 28.03.2008 i KLD-së “Për funksionin drejtues në gjykata”;
- ✚ Vendimi i KLD-së i datës 27.09.2010 “Për rregullat e hollësishme për sistemin e pikëzimit të detyrueshëm për zbatim, në rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për plotësimin e vendeve vakante në gjykatat e apelit dhe gjykatat për krime të rënda”;
- ✚ Vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010 i KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”.

Promovimi

Bazuar në ligjin nr. 9877/2008, rastet e promovimit të një gjyqtari i korrespondojnë:

- Emërimit si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë për krime të rënda;
- Emërimit si gjyqtar në gjykatat e apelit të zakonshëm dhe për krime të rënda;
- Emërimi në pozicionin e kryetarit të gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit;

Ligji nr. 9877/2008 përcakton kriteret për emërimin si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë për krimet e rënda. Këto kriteret janë eksperiencia në punë si gjyqtar pranë gjykatës së shkallës së parë për jo më pak se 5 vjet, dallimi për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale, vlerësimi i aftësive profesionale me nivelin “shumë mirë” të zhvilluar në dy herët e fundit, dhe mungesa e masave disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit. Nga ana tjetër, për emërimin si gjyqtar në gjykatat e apelit dhe të apelit për krimet e rënda kriteret janë të njëjta me ato të përcaktuara për emërimin e gjyqtarëve në gjykatën e krimeve të rënda, me përjashtim të eksperiencës në punë si gjyqtarë pranë gjykatave të shkallës së parë, e cila në këtë rast duhet të jetë 7 vjet. Ndërkohë që për emërimin si kryetar i gjykatës së shkallës së parë apo gjykatës së apelit, ligji parashikon se kandidatët duhet të kenë punuar jo më pak se katër vjet si gjyqtarë në gjykatat e të njëjtit nivel ose të niveleve më të larta; të jenë vlerësuar “Shumë mirë” nga KLD dy herët e fundit; të mos kenë masë disiplinore në fuqi; të kenë aftësi organizuese dhe menaxhuese; si dhe të mos jenë anëtarë të KLD-së.

Ligji nr. 9877/2008 parashikon se për emërimin në Gjykatën e Krimeve të Rënda, në Gjykatat e Apelit dhe në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, KLD i propozon Presidentit kandidatët e përzgjedhur me pikëzim, sipas kriterëve të vjetërsisë në profesion, të rezultateve të punës në vijimësi, në përputhje me renditjen në listën e përhershme, si dhe të veprimtarisë shkencore e akademike.

Vendet vakante për gjyqtarë në të dyja shkallët e gjyqësorit shpallen publikisht nga KLD me propozim të Ministrisë të Drejtësisë, jo më vonë se një muaj para mbledhjes. Shpallja bëhet në mediat e shkruara dhe asaj audio-vizive sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 28 të Ligjit Nr. 8811/2001. Nëse vendi vakant është krijuar si rezultat i shkarkimit të gjyqtarit nga detyra dhe gjyqtari ka paraqitur ankim në Gjykatën e Lartë, atëherë procedurat për emërimin e një gjyqtari tjetër në këtë vend vakant pezullohen. Veprimet e mëtejshme për plotësimin e vendit vakant rifillojnë ose jo sipas vendimit të marrë nga Gjykata e Lartë.

Ligji nr. 9877/2008 parashikon se për emërimin në Gjykatën e Krimeve të Rënda, në Gjykatat e Apelit dhe në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, KLD i propozon Presidentit kandidatët e përzgjedhur me pikëzim, sipas kriterëve të vjetërsisë në profesion, të rezultateve të punës në vijimësi, në përputhje me renditjen në listën e përhershme, si dhe të veprimtarisë shkencore e akademike.

Për mënyrën e përzgjedhjes së gjyqtarëve janë parashikuar rregulla të posaçme në nenet 28 e 29 të Ligjit Nr. 8811/2001, në nenet 28 e 29 të tij. Në këto dispozita ligjore është sanksionuar shpallja publike e vendeve vakante në gjykata në median e shkruar dhe atë vizive, si edhe modalitetet e publikimit. Në zbatim të këtyre dispozitave, KLD, me vendimin 137, datë 21.02.2003, ka miratuar rregulloren e Komisionit të Posaçëm të Këshillit për shqyrtimin e kandidatëve për gjyqtarë dhe testimin e tyre. Komisioni përbëhet nga:

- o Zv/Kryetari i KLD-së;

- Drejtori i Shkollës së Magjistraturës;
- Kryeinspektori i KLD-së;
- Një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë;
- Kryetari i Komisionit të Ngritjes Profesionale të Konferencës Gjyqësore Kombëtare.

Komisioni, në përfundim të afatit të përcaktuar në shpalljen publike, evidenton kandidatët që plotësojnë kriteret ligjore për t'u emëruar gjyqtar, duke pasqyruar në një listë të veçantë, kandidatët që nuk plotësojnë këto kriteret. Për secilin kandidat që plotëson kriteret ligjore, nga komisioni evidentohen gjithashtu: -rezultatet e përfundimit të studimeve universitare ose pasuniversitare; -vjetërsia si jurist; -rezultatet e punës; -trajnimet apo specializimet e ndryshme; -të dhëna për studime të kryera apo botime në fushën juridike; -të dhëna për qëndrimin moral; -të dhënat për masat disiplinore apo çdo të dhënë tjetër që tregojnë epërsi të një kandidati ndaj të tjerëve. Kur çmohet nga komisioni, për kandidatët që plotësojnë kriteret ligjore organizohet testimi i tyre duke i njoftuar të paktën 10 ditë para realizimit të tij. Ky komision ndjek të njëjtën procedurë edhe për plotësimin e vendeve vakante pranë gjykatave të apelit.

Në bazë të nenit 30 të Ligjit nr. 8811/2001, KLD vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm për kandidaturat fituese që do t'i propozohen Presidentit të Republikës dhe e shpall vendimin publikisht. Presidenti i Republikës nuk merr pjesë në votim. Presidenti, brenda 30 ditëve, nxjerr dekretin për emërimin në detyrën e gjyqtarit të kandidatit të propozuar nga KLD. Pas këtij afati, propozimi vlerësohet i rrëzuar dhe KLD përsërit procedurat për shqyrtimin e kandidaturave për vendin vakant.

Neni 12 i ligjit nr. 9877/2008 njeh sistemin e karrierës në pushtetin gjyqësor sepse një nga kriteret për t'u emëruar si gjyqtar në gjykatën e apelit është eksperiencia e punës si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë. Për efekt të karrierës profesionale, Ligji nr. 9877/2008 autorizon KLD të mbajë një listë të përhershme të renditjes së gjyqtarëve për rezultatet e punës që nga momenti i emërimit për herë të parë, listë e cila përditësohet periodikisht. Renditja e gjyqtarëve në listën e përhershme bëhet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të KLD-së. Vlerësimi i aftësive profesionale të gjyqtarëve që shërben si një ndër elementët përcaktues në renditjen e listës së mësipërme, kryhet nga KLD sipas kushteve të përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr. 9877/2008.

Kryetarët e Gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Apelit, në bazë të Nenit 16 të Ligjit nr. 9877/2008 emërohen nga KLD sipas një procesi konkurrimi, sipas rregullave të vendosura në vendimin e KLD-së "Për funksionin drejtues në gjykata".

Gjithashtu në ligjin 9877/2008, në nenin 43, pika 2, është sanksionuar se kandidatët që konkurrojnë për gjyqtar në gjykatat për krime të rënda ose në gjykatat e apeleve, i nënshtrohen vlerësimit të aftësive profesionale me procedurë të përshpejtuar sa kohë që për konkurrentët nuk është realizuar vlerësimi i aftësive sipas kriterit të lartpërmendur ligjor. Sipas nenit 12 të ligjit 9877/2008 promovimi i gjyqtarëve nga KLD kryhet më anë të një përzgjedhjeje përmes pikëzimit, sipas kriterëve të vjetërsisë në profesion, rezultateve të punës në vijimësi, veprimtarisë shkencore dhe akademike. Ky nen parashikon gjithashtu se rregulla më të hollësishme mbi pikëzimin përcaktohen me vendim të KLD-së. Rrjedhimisht, bazuar në paragrafin 4 të nenit 12 të ligjit 9877/2008 është miratuar vendimi "Për rregullat e hollësishme për sistemin e pikëzimit të detyrueshëm për zbatim, në rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për plotësimin e vendeve vakante në gjykatat e apelit dhe gjykatat për krime të rënda".

Ky vendim parashikon ngritjen e një grupi pune, përbërja e të cilit miratohet nga KLD, në mbledhjen e parë të fillimit të vitit kalendarik. Ky grup pune, i përbërë nga 3 anëtarë, përgjatë gjithë vitit kalendarik ka si detyrë parësore përllogaritjen e pikëve për kandidaturat për gjyqtar në gjykatat e apelit dhe në gjykatat për krimet e rënda. Sa i takon kriteret të pikëzimit ato mbështeten tek:

- Vjetërsia në profesion;
- Rezultatet e punës në vijimësi;
- Veprimtaria shkencore dhe akademike.

Pikët maksimale që mund të arrihen nga sistemi i pikësimit janë 200 prej të cilave 100 pikë i atribuohen vjetërsisë në profesion, 80 rezultateve të punës në vijimësi dhe 20 pikë veprimtarisë shkencore dhe akademike. Sa i takon vjetërsisë në profesion, parashikohen 3 pikë për çdo vit eksperiencë profesionale si gjyqtar, deri në një maksimum prej 80 pikësh dhe 2 pikë shtesë për çdo vit eksperiencë profesionale si gjyqtar i gjykatës së apelit deri një një maksimum prej 20 pikësh. Për rezultatet e punës në vijimësi parashikohen 60 pikë për vlerësimin total “shumë mirë” dhe, nëse vlerësimi “shumë mirë” është arritur për secilin nga tre grupimet e kriterëve të vlerësimit, kandidati merr 80 pikë në total. Për veprimtarinë shkencore dhe akademike parashikohen 10 pikë për titujt shkencore, 5 pikë për botimet shkencore, dhe nga 3-10 pikë për ushtrimin për një periudhë të caktuar të funksioneve të tilla si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, Drejtor i Shkollës së Magjistraturës, Anëtar i KLD-së.

Përveç sa më sipër, me anë të vendimit të KLD “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, është miratuar një sistem vlerësimi që ka për qëllim të evidentojë vlerat profesionale të gjyqtarëve për efekt të karrierës së tyre, të identifikojë gjyqtarët që rezultojnë me pamjaftueshmëri profesionale dhe gjyqtarët me cilësi më të lartë, të konstatojë problematikat që ndeshen në gjykata gjatë verifikimit të veprimtarisë së tyre profesionale, si dhe të identifikojë nevojat për trajnim të gjyqtarëve, në shërbim të rritjes së profesionalizmit të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, si dhe kryetarëve të këtyre gjykatave. Vendimi parashikon se vlerësimi i punës së gjyqtarit kryhet duke vlerësuar të gjithë elementët e procesit të punës, përmes tre fazave të vlerësimit e para prej të cilave i korrespondon vlerësimit të kryetarit të gjykatës i ndjekur nga vetëvlerësimi i gjyqtarit, e dyta raportit konstatohet dhe projektaktit të vlerësimit nga Inspektorati i KLD-së dhe e treta aktit të vlerësimit nga KLD.

Transferimi

Në lidhje me transferimin e gjyqtarëve neni 21 i ligjit nr. 9877/2008 parashikon si kusht të domosdoshëm për transferimin, pëlqimin e gjyqtarit, me përjashtim të rasteve kur transferimi diktohet nga nevojat e riorganizimit të gjyqësorit.

II. Avantazhet dhe disavantazhet e sistemit të vjetër të promovimit dhe transferimit dhe sistemit të ri të pikëzimit;

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për organizimin e gjyqësorit në vitin 2008 u shfuqizua ligji nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili rregullonte, edhe pse në mënyrë shumë të cunguar, mënyrën e promovimit dhe transferimit të gjyqtarëve. Neni 24 i tij, parashikonte se gjyqtarët e gjykatës së shkallës së parë për krimet e rënda dhe të apelit emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të KLD-së, mbi bazën e konkurrimit, pasi të kenë punuar jo më pak se pesë vjet në gjykatat e

shkallës së parë dhe të jenë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale. Kryetarët dhe zëvendëskryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të KLD-së. Nga ana tjetër, neni 28 parashikonte se ngritja në përgjegjësi dhe transferimi i gjyqtarit nga puna e tij bëhet vetëm me pëlqimin e tij/saj, përveç rasteve të parashikuara nga ky ligj.

Dispozitat e sipërcituara ligjore ishin parashikimi i vetëm ligjor lidhur me promovimin (ngritjen në përgjegjësi) dhe transferimin e gjyqtarëve. Ligji nr. 8436/1998, i shfuqizuar, nuk delegonte rregullimin e aspekteve të veçanta që lidhen me promovimin apo transferimin e gjyqtarëve në akte nënligjore të KLD-së. Kështu, mungonte rregullimi i posaçëm mbi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale dhe cilësive të larta etiko-morale të gjyqtarëve, duke sjellë si pasojë promovime të bëra pa procedura të qarta, mbi vlerësime tërësisht subjektive dhe aspak transparente. Tentativa që bëri KLD nëpërmjet miratimit të Vendimit nr. 193/2, datë 11.05.2006 “Sistemi i Vlerësimit të Aftësive Profesionale të Gjyqtarëve”, edhe pse e mirëpritur, rezultoi e paefektshme. Megjithëse KLD, e ndryshoi këtë vendim edhe dy herë të tjera (nëpërmjet VKLD nr. 207/2, datë 07.02.2007 dhe VKLD 238/1/c, datë 24.12.2008) përsëri situata ngeli e pazgjidhur dhe sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve pothuajse nuk u zbatua, duke mos realizuar edhe një ndër qëllimet e tij, që ishte përdorimi i rezultateve të vlerësimit, si një bazë e rëndësishme për promovimin dhe transferimin e gjyqtarëve. Në këtë kuadër, ishte e domosdoshme ndërmarrja e reformës ligjore për përmirësimin e situatës ligjore dhe faktike mbi promovimin dhe transferimin e gjyqtarëve, sepse sistemi i promovimit dhe transferimit, sipas ligjit nr. 8436/1998 nuk paraqiste asnjë avantazh, për shkak se pothuajse ishte i pa normuar me ligj.

Situata duket të jetë përmirësuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9877/2008, i cili jo vetëm shtoi kriteret lidhur me promovimin e gjyqtarëve, por qartësisht delegoi rregullimin e aspekteve të veçanta të promovimit në akte nënligjore të KLD-së. Nëpërmjet VKLD nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve” dhe VKLD i datës 27.09.2010 “Për rregullat e hollësishme për sistemin e pikëzimit të detyrueshëm për zbatim, në rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për plotësimin e vendeve vakante në gjykatat e apelit dhe gjykatat për krime të rënda”¹ u krijua baza e nevojshme ligjore për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, si komponent i rëndësishëm për t’u marrë në konsideratë në rastin e promovimit apo transferimit të gjyqtarëve. Nga ana tjetër, nëpërmjet VKLD nr. 227/2, datë 28.03.2008 “Për funksionin drejtues në gjykata” u përcaktuan rregulla të qarta, kritere e procedura specifike për promovimin e gjyqtarëve në postin e Kryetarit të gjykatës.

Këto akte ligjore dhe nënligjore prezantuan për herë të parë në drejtim të promovimit:

- a) përzgjedhjen me pikëzim, sipas kritereve të vjetërsisë në profesion, rezultateve të punës në vijimësi, si dhe veprimtaria shkencore dhe akademike e gjyqtarit;
- b) rregulla dhe procedura të qarta dhe transparente për vlerësimin e gjyqtarëve;
- c) kriteret mbi rregullat e pikëzimit të gjyqtarëve.

Në këtë kuadër, sistemi i ri i vlerësimit të gjyqtarëve dhe ai i pikëzimit paraqesin shumë avantazhe krahasuar me sistemin e vjetër, që në fakt nuk kishte asnjë avantazh krahasuar me të. Avantazhet e sistemit të ri mund të listohen si më poshtë:

¹ Akte të miratuara në zbatim të neneve 12 dhe 13 të ligjit nr. 9877/2008

- 1) Krijimi i bazës së nevojshme ligjore për zbatimin e parimit të meritokracisë në promovimin dhe transferimin e gjyqtarëve, duke vënë në zbatim vlerësimin profesional të tyre, si kriter që duhet të shoqërojë në çdo rast ecurinë në karrierë të funksionarëve publikë, ku nuk ka arsye për përjashtimin e gjyqtarëve;
- 2) Krijimi i një sistemi më transparent të promovimit dhe transferimit të gjyqtarëve;
- 3) Nxitja e përgjegjshmërisë më të lartë të gjyqtarit në përmbushjen e detyrës së tij kushtetuese, si dhe e vëmendjes dhe kujdesit të tij të veçantë e të vazhdueshëm për rritje profesionale apo veprimtari akademike e shkencore.
- 4) Krijimi i një mjedisi të sigurt për gjyqtarin, se puna e tij me cilësi të lartë profesionale, është jo vetëm shërbim ndaj qytetarit, por edhe një investim për ecurinë e tij në karrierë, duke vënë në zbatim parimin e “shpërblimit për punë të mirë”.

Këto avantazhe, edhe pse në pamje të parë të krijojnë përshtypjen se janë vetëm në favor të ecurisë në karrierë të gjyqtarit, në fakt janë arritje me ndikim të drejtpërdrejtë në garantimin e efikasitetit në dhënien e drejtësisë dhe mbrojtjen efikase të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Një sistem gjyqësor i ndërtuar mbi baza thellësisht meritokracie, ofron siguri për një drejtësi që funksionon sipas standardeve të shtetit ligjor dhe që garanton parimin e procesit të rregullt ligjor. Për këtë arsye, funksionimi i rregullt i sistemit të pikëzimit dhe vlerësimit të gjyqtarëve, duhet të jetë një nga çështjet më të rëndësishme të punës së KLD-së, për të siguruar se ai e përmbush më së miri qëllimin për të cilin legjislatori e ka parashikuar.

Pavarësisht se procesi i promovimit dhe transferimit të gjyqtarëve, nëpërmjet miratimit të sistemit të ri të pikëzimit dhe vlerësimit profesional, pranohet gjerësisht se ka bërë hapa të dukshëm përpara, përsëri ai paraqet disa probleme, që shndërrohen në disavantazhe të tij. Këto disavantazhe nuk paraqiten të tilla që të vënë në diskutim qëllimin parimor të sistemit të pikëzimit, por adresimi në mënyrë të përshtatshme i qëllimit të legjislatorit, kërkon përsosjen e mëtejshme të këtij sistemi. Në këtë kontekst, evidentimi problematikave të sistemit aktual përbën hapin e parë të domosdoshëm drejt kësaj përsosjeje. Konkretisht, rregullat e detajuara të sistemit të pikëzimit të përcaktuar përmes vendimit të KLD-së shfaqin problemet e mëposhtme:

1. Raporti i vendosur midis kriterit të vjetërsisë në profesion dhe kriterit të rezultateve të punës në vijimësi. Nga analiza e nenit 12 të ligjit nr. 9877/2008 evidentohet se legjislatori, në përcaktimin e kriterëve për promovimin e gjyqtarëve në gjykatën për krimet e rënda dhe në gjykatën e apelit, ndërsa si një nga kriteret parashikon atë të vjetërsisë në profesion, respektivisht 5 dhe 7 vjet, përcakton edhe dy kriterë të tjera që lidhen drejtpërdrejt me rezultatet e punës në vijimësi, dhe konkretisht kriteri që gjyqtari të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale dhe kriteri që gjyqtari të jetë vlerësuar “shumë mirë” për aftësi profesionale dy herët e fundit. Duke qenë se nga katër kriteret ligjore për promovimin e gjyqtarit, dy prej tyre i referohen rezultateve të punës në vijimësi, del qartë se legjislatori ka patur si qëllim dhënien e rëndësisë parësore profesionalizmit në ushtrimin e profesionit. Rregullat e detajuara mbi sistemin e pikëzimit, në atribuimin e pikëve përkatëse secilit prej kriterëve (vjetërsia në profesion, rezultatet e punës në vijimësi dhe veprimtaria shkencore e akademike) duhej të kishin reflektuar pikërisht këtë qëllim të legjislatorit.

Vendimi i KLD-së ka përcaktuar 100 pikë për vjetërsinë në profesion dhe 80 pikë për rezultatet e punës në vijimësi, duke krijuar një disproporcion që nuk duket të jetë në përputhje me frymën e ligjit. Ndërsa vjetërsia në profesion është pa dyshim e rëndësishme, vlen të theksohet se rezultatet e punës në vijimësi, janë dëshmi e qartë e mënyrës së ushtrimit të profesionit përgjatë harkut kohor të këtyre viteve vjetërsi dhe në raportin midis dy kriterëve, duhet të ketë një ekuilibër më të përshtatshëm mes tyre, me tendencën për të

prevaluar kriteri i rezultateve të punës në vijimësi si tregues i nivelit të profesionalizmit, aftësisë dhe përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksionit. Do të ishte e paarsyeshme që në përcaktimin e kandidaturës fituese ndërmjet një kandidati që plotëson kriterin e vjetërsisë në profesion sipas përcaktimit ligjor dhe është vlerësuar “shumë mirë” në të gjithë komponentët e vlerësimit dhe një kandidati që ka disa vite më shumë eksperiencë, por nuk është vlerësuar “shumë mirë” në të gjithë komponentët, të ndikonte numri i viteve në profesion. Fakti që legjislatori ka përcaktuar qartë vitet e eksperiencës së kërkuar për promovim, duke i konsideruar ato si të mjaftueshme për ngritjen në karrierë të gjyqtarit, dëshmon për peshën më të madhe që ai ka patur si qëllim t’i japë kriterit të rezultateve të punës në vijimësi, ndaj dhe numri i viteve, kur kandidatët gjithësi plotësojnë kriterin minimum të kërkuar, nuk duhet të përbëjë shkak për favorizimin e kandidatit me më shumë vite eksperiencë kur rezultatet e punës në vijimësi janë të ndryshme e në favor të kandidatit me më pak vite përvojë. Do të ishte e përshtatshme që vitet e vjetërsisë në profesion të kishin ndikim vetëm në rastet kur rezultatet e punës në vijimësi do të ishin të njëjta. Në çdo rast tjetër, rezultatet e punës në vijimësi duhet të jenë vendimtare.

Vjetërsia në profesion është një kriter që përdoret gjerësisht në mekanizmat e promovimit, si në sistemin publik, ashtu edhe në sistemin privat. Arsyeja e thelbit të këtij kriteri është përmirësimi i aftësive profesionale përmes përvojës, duke pranuar standardin që eksperiencia përmirëson performancën e punëmarrësit. Për këtë shkak, kriteri i vjetërsisë nuk mund të vlerësohet mekanikisht i shkëputur nga rezultatet në vijimësi në profesion, por midis tyre duhet gjetur një ekuilibër i përshtatshëm për të evituar situata kontradiktore. Në kontekstin e pushtetit gjyqësor shqiptar, nevoja për një ekuilibër të përshtatshëm bëhet edhe më e domosdoshme për shkak të zhvillimeve politiko-sociale (vjetërsia mesatare e gjyqtarëve në profesion; koha e ndryshme e diplomimit të tyre në kohë “gjatë dhe pas komunizmit”; mënyra e ndryshme e diplomimit nga kurset gjashtëmujore, universitetet juridike deri tek Shkolla e Magjistraturës).

2. Rregullimi i bërë në shkronjën “b” të pikës, 2.1.2 të vendimit të KLD-së, është i paqartë dhe duket se nuk i përgjigjet kriterit të vendosur nga ligji për rezultatet e punës në vijimësi. Formula e parashikuar, nga gjuha e përdorur në vendim – “vlerësimi”, por edhe nga fakti se nuk përcakton rregulla mbi mënyrën e ndërthurjes së rezultateve të vlerësimeve në vijimësi për të mbërritur tek një rezultante e punës në vijimësi, duket se i referohet vetëm një vlerësimi të vetëm. Gjithashtu, kjo pikë nuk siguron lidhjen e nevojshme të kërkuar nga ligji 9877/2008, të rezultateve të punës në vijimësi me listën e përhershme të renditjes së gjyqtarëve. Neni 12 i ligjit 9877/2008 kërkon shprehimisht referimin tek kjo listë në përcaktimin e rezultateve të punës në vijimësi.

3. Sistemi i pikëzimit nuk mund t’i përgjigjet në mënyrë të përshtatshme kërkesave të ligjit 9877/2008 në mungesë të një akti me rëndësi të posaçme në vlerësimin e njërës prej kriterëve të promovimit të gjyqtarëve dhe konkretisht, vendimit të parashikuar nga neni 14 i ligjit 9877/2008 i cili duhet të përcaktojë kriteret për renditjen e gjyqtarit në listën e përhershme për rezultatet e punës në vijimësi. Miratimi më parë në kohë i vendimit të KLD-së, krijon premisa që ky akt ose do të mbetet i pazbatueshëm ose, nëse do të zbatohet, do të zbatohet jo në përputhje me ligjin.

4. Kriteri i tretë mbi veprimtarinë shkencore dhe akademike jo vetëm nuk përmban të gjithë komponentët që do duhej të merreshin në konsideratë për vlerësimin e kësaj veprimtarie, por parashikon edhe komponentë që duket se nuk i përgjigjen konceptit të veprimtarisë shkencore dhe akademike, por i referohen konkretisht veprimtarisë institucionale. Kështu, ndërsa nga njëra anë në veprimtarinë shkencore dhe akademike, krahas titujve shkencorë dhe

botimeve shkencore, do të duhej të përfshihej edhe ajo përmasë e veprimtarisë akademike që i korrespondon përvojës së punës si pedagog, nga ana tjetër nuk mund të përfshihen përvojat profesionale të llojit gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese apo Gjykatën e Lartë apo anëtar i KLD-së. Pavarësisht këtij konstatimi, përvoja si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese apo i Gjykatës së Lartë, mund të përfshihej si komponent i vlerësimit të përvojës profesionale, sikundër është parashikuar për përvojën si gjyqtar në gjykatat e apelit. Ndërkohë, mbetet e pajustificuar përfshirja në komponentët e vlerësimit të secilit kriter, përvoja si anëtar i KLD-së. Vlen të theksohet se zgjedhja si anëtar i këtij institucioni përbën një mundësi për të zgjedhurin për të kontribuar në forcimin e sistemit dhe jo mundësi për të përfituar prej këtij sistemi, aq më tepër përmes vendimeve të miratuara nga vetë ky institucion, që jep përshtypje madje të konfliktit të interesit.

III. Situata ligjore dhe faktike e sistemit të transferimit

Rregullat mbi transferimin e gjyqtarëve përcaktohen shprehimisht në nenin 147 të Kushtetutës, ku parashikohet se KLD është organi përgjegjës që vendos për transferimin e gjyqtarëve dhe ky transferim nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tyre, përveçse kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor. Ky parashikim kushtetues vendos katër rregulla të rëndësishme mbi transferimin e gjyqtarëve:

- i) organi i vetëm që mund të vendos mbi transferimin është KLD;
- ii) transferimi si rregull bëhet vetëm me pëlqimin e gjyqtarit;
- iii) përjashtimisht transferimi bëhet edhe pa pëlqimin e gjyqtarët, kur një gjë e tillë diktohet nga nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor;
- iv) emërimi i gjyqtarit është i ndryshëm nga transferimi i gjyqtarit.

I njëjti parashikim është bërë edhe në ligjin nr. 9877/2008, duke mos e detajuar më tej parashikimin e bërë nga Kushtetuta. Ndërkohë që ligji nr. 8811/2001, edhe pse Kreu IV i tij, titullohet “Emërimet dhe transferimet e gjyqtarëve”, nuk parashikon asnjë rregull mbi çështjet e transferimit të gjyqtarëve. Mungesa e detajimit të rregullave kushtetuese në ligjin nr. 9877/2008 dhe ligjin nr. 8811/2001, ka sjellë një vakuim ligjor mbi kriteret e qarta dhe transparente mbi transferimin e gjyqtarëve. Ligji duhet të zbërthente në mënyrë të plotë secilin prej rregullave të parashikuara nga Kushtetuta, duke përcaktuar:

- a) procedura të qarta dhe transparente për KLD-në gjatë vendimmarrjes për transferimin e gjyqtarëve;
- b) rregulla të detajuara për rastet e transferimit pa pëlqim të gjyqtarëve, duke shpjeguar edhe nocionin kushtetues “riorganizim të sistemit gjyqësor”;
- c) rregulla të detajuara për rastet e transferimit të gjyqtarëve me pëlqimin e tyre, duke saktësuar dallimin midis emërimit si gjyqtar dhe transferimin të gjyqtarit.

Mungesa e procedurave të qarta dhe transparente mbi vendimmarrjen e KLD-së apo e kritereve mbi transferimin me apo pa pëlqim të gjyqtarëve, paraqet probleme për shkak të subjektivizmit që shoqëron këtë procedurë. Nga analiza e vendimeve më të fundit të KLD-së, rezulton se me Vendimin nr. 270, datë 12.11.2010, ky organ ka vendosur:

“Diskutoi mbi zgjidhjen përfundimtare të problemit të krijuar në gjykatat e rretheve gjyqësore Elbasan, Mat, dhe Dibër për shkak të numrit më të lartë të gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën e gjyqtarit, sesa numri i caktuar në organikë. Bazuar në vendet vakante të krijuara nga Dekreti i Presidentit të Republikës Nr. 6265, datë 16.09.2009 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë dhe apelit”, në përfundim vendosi:

a- Riorganizimin e gjykatës së rrethit gjyqësor Elbasan, duke transferuar një gjyqtar të gjykatës së sipërcituar, në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë. Ky vendim do t'ju komunikohet gjyqtarëve të gjykatave respektive.

b- Riorganizimin e gjykatës së rrethit gjyqësor Mat, duke transferuar një gjyqtar të gjykatës së sipërcituar, në gjykatën e rrethit gjyqësor Kurbin. Ky vendim do t'ju komunikohet gjyqtarëve të gjykatave respektive.

c- Riorganizimin e gjykatës së rrethit gjyqësor Dibër, duke transferuar një gjyqtar të gjykatës së sipërcituar, në gjykatën e rrethit gjyqësor Shkodër. Ky vendim do t'ju komunikohet gjyqtarëve të gjykatave respektive.”.

Për shkak të mungesës së arsytimit të këtij vendimi, si dhe vakuimit ligjor mbi çështjen e transferimit të gjyqtarëve, mbeten të paqarta dy momente:

1- Kriteret që ka zbatuar KLD në përcaktimin e gjyqtarëve që janë transferuar nga gjykata ku ushtronin funksionin, në një gjykatë tjetër;

2- Shkaqet pse situata është vlerësuar nga KLD, si riorganizim i gjykatave respektive, duke qenë se ligji nuk përkufizon nocionin e “riorganizimit të sistemit gjyqësor” dhe aq më pak nuk përcakton rastet se kur një situatë vlerësohet si “riorganizim i gjykatës”.

Ndërkohë që po i njëjti vendim i KLD-së nr. 270/2010 nuk trajton si riorganizim rastin e krijimit të Gjykatës së Përmetit, me Dekretin nr. 6201, datë 08.06.2009 të Presidentit të Republikës. Ky konstatim arrihet nga fakti se nëse do të ishte cilësuar si i tillë, si rregull organika e kësaj gjykata duhet të ishte plotësuar me gjyqtarët e gjykatave, numri organik i të cilave është ulur. Në këtë rast, KLD nuk ka vepruar duke transferuar pa pëlqim, gjyqtarë të gjykatave të tjera, sikurse Kushtetuta përcakton, por ka vepruar me emërime fillestare. KLD ka mbajtur fillimisht këtë qëndrim me VKLD nr. 251, datë 29.07.2009:

“Pasi diskutoi mbi masat që duhen marrë për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, -miratuar me Dekretin Nr. 6201, datë 08.06.2009 të Presidentit të Republikës-, për të përcaktuar numrin e gjyqtarëve që duhet të ketë në përbërje të saj kjo gjykatë, si dhe mënyrën e emërimit të gjyqtarëve të saj, në përfundim, vendosi që: duke e parë këtë çështje të lidhur me riorganizimin e mundshëm të gjykatave, ta shqyrtojë atë, pasi Presidenti i Republikës të shprehet në lidhje me projekt dekretin “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë dhe të apelit”.

Edhe pas daljes së Dekretit nr. 6265, datë 16.09.2009 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë dhe të apelit”, përsëri krijimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet nuk u trajtua nga KLD si situatë e riorganizimit të sistemit gjyqësor. Kjo për faktin që me VKLD nr. 256, datë 02.12.2009 u shpallën vendet vakante për në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, të rishpalluara si vakante edhe me VKLD nr. 268, datë 15.09.2010. Ndërkohë që më parë me VKLD nr. 265, datë 15.06.2010 në këtë gjykatë ishin caktuar si gjyqtarë, dy të sapo-diplomuar në Shkollën e Magjistraturës. Vendet e tjera vakante u plotësuan me VKLD nr. 270, datë 12.11.2010, ku u emëruan si gjyqtarë dy kandidatë të ardhur jashtë sistemit gjyqësor, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 11 të ligjit nr. 9877/2008 (emërim fillestar).

Ky rast ilustron për zbatimin e kriterëve të ndryshme nga KLD mbi nocionin “riorganizim i sistemit gjyqësor”. Kjo ka krijuar situata preferenciale, ku si shkak i vlerësimit të një situatë të caktuar si “riorganizim i sistemit gjyqësor”, mund të jenë bërë transferimi për shkaqe tërësisht subjektive. Për këtë qëllim lind nevoja të sqarohet konceptimi i “riorganizimit të sistemit gjyqësor”.

Kushtetuta dhe ligji nr. 9877/2008, përcaktojnë rregulla të përgjithshme mbi organizimin e

pushtetit gjyqësor. Me dekretet e Presidentit të Republikës të dala në zbatim të tyre vendoset një organizim më konkret dhe specifik në përputhje me rregullat e përgjithshme të organizimit. Ky organizim specifik që përcakton numrin e gjykatave, qendrat e ushtrimit të veprimtarive të tyre dhe kompetencat territoriale, lipset të rivlerësohet herë pas here për të reflektuar nevojat dhe për të adresuar problemet e sistemit gjyqësor në përgjithësi. Rrjedhojë e mundshme e rivlerësimit, mund të jetë riorganizimi gjyqësor.

Riorganizimi gjyqësor nënkupton ndryshimin e numrit ekzistues të gjykatave që passjell dhe ndryshimin e kompetencave territoriale apo lëndore të tyre. Riorganizimi mund të realizohet në format e mëposhtme:

- Njëpërmjet suprimimit të gjykatave më të vogla dhe përfshirjes së tyre në gjykata më të mëdha të cilat marrin kompetencat territoriale dhe stafin e gjykatave të suprimuara (Një shembull është përfshirja e gjykatave të rretheve gjyqësore Përmet dhe Tepelenë në gjykatën e rrethit gjyqësor Gjirokastrë me dekretin e Presidentit të Republikës me nr. 5350, datë 11.6.2007 “Për krijimin e rretheve gjyqësore, caktimin e kompetencave tokësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre”.);
- Njëpërmjet ndarjes apo veçimit prej një gjykate ekzistuese dhe krijimit të një gjykate të re (Një shembull është veçimi i gjykatës së rrethit gjyqësor Përmet nga gjykata e rrethit gjyqësor Gjirokastrë me Dekretin e Presidentit të Republikës me nr. 6201, datë 8.6.2009 “Për caktimin e kompetencave tokësore të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së secilës prej tyre”);
- Njëpërmjet ndarjes së gjykatave, me qëllim krijimin e gjykatave të specializuara, sipas kompetencave lëndore. (Një shembull mund të jetë ndarja e seksionit administrativ të një gjykate ekzistuese për të krijuar një gjykatë të re apo ndarja e një gjykate apeli sipas juridiksionit, në gjykatë apeli civile dhe në gjykatë apeli penale).

Riorganizimi mund të jetë i menjëhershëm, por mund edhe të kryhet në mënyrë graduale. Në rastin e përfshirjes së gjykatave më të vogla në një gjykatë më të madhe, riorganizimi gradual mund të realizohet në tri hapa²:

1. Kthimi i gjykatave të vogla në degë të gjykatave të mëdha përthithëse, por duke i lënë këtyre degëve kompetenca të plota.
2. Reduktimi i kompetencave të degëve duke u shtrirë vetëm tek kundravajtjet penale apo tek konfliktet civile me vlera që arrijnë deri në një kufi të caktuar.
3. Mbyllja e plotë e tyre.

Arsyet e riorganizimit gjyqësor mund të jenë të ndryshme. Me synimin për rritjen e efikasitetit të gjykatave të vogla, mund të vendoset përfshirja e tyre në gjykata më të mëdha. Krahas efikasitetit, riorganizimi mund të ketë për qëllim edhe uljen e kostove të gjyqësorit apo krijimin e mundësive më të mëdha për aksesin e publikut në gjykata. Çështja e përcaktimit qartësisht se kush konsiderohet “riorganizim gjyqësor”, duhet të jetë e përcaktuar qartësisht në ligj, për të shmangur çdo përcaktim subjektiv mbi këtë koncept.

² Studim i Misionit EURALIUS, Rekomandime mbi Modele të Ndryshme Riorganizimi

Një tjetër problematikë për procesin e transferimit buron edhe nga VKLD nr. 216, datë 28.09.2007, sipas të cilit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës janë cilësuar si “gjykata karriere” dhe që shërbejnë për promovimin e gjyqtarëve të cilët punojnë aktualisht në sistemin gjyqësor. Në thelb, një përcaktim i tillë është i paqartë, përse kohë nuk jepet kuptimi i “gjykatës së karrierës” dhe se ky nocion është i huaj për legjislacionin shqiptar. Megjithatë, duket që cilësimi i tyre si gjykata karriere është normuar nga këndvështrimi preferencial i gjyqtarëve, të cilët në vijimësi kërkojnë të emërohen/transferohen pikërisht në këto gjykata. Dallimi midis gjykatave të rretheve gjyqësore, të çon në një paragjykim mbi sistemin gjyqësor sepse në mënyrë të heshtur pranohet se gjyqtarët e Gjykatës së Tiranës dhe Durrësit kanë nivel më të lartë profesional se kolegët e tyre të rretheve të tjera gjyqësore dhe nga ana tjetër pranohet në mënyrë të heshtur që cilësia e drejtësisë e ofruar për qytetarët në këto gjykata është më e lartë. Gjithashtu, një parashikim i tillë konfondon edhe procesin e promovimit me atë të transferimit. Ky fakt është lehtësisht i dallueshëm teksa krahason përmbajtjen e vetë vendimeve të KLD-së. Ndërsa VKLD nr. 216/2007 përmend se “gjykatat e karrierës” shërbejnë për promovimin e gjyqtarëve, vendimmarrjet e herë pas hershme të KLD-së për emërimin e gjyqtarëve në këto gjykata, përcaktojnë se ky organ ka vendosur transferimin e gjyqtarëve nga një gjykatë e një rrethi të caktuar gjyqësor, për në një nga “gjykatat e karrierës”. Kjo situatë e paqartë ilustron me VKLD nr. 260, datë 01.04.2010, me anë të të cilit KLD ka transferuar disa gjyqtarë në Gjykatën e Tiranës dhe Gjykatën e Durrësit. Ky rast mund të etiketohet si ngatërrim të promovimit me transferimin i shkaktuar me një akt nënligjor i KLD-së, që ka barazuar promovimin me transferimin. Kushtetuta dhe ligji nr. 9877/2008 kanë bërë një dallim të qartë midis këtyre dy koncepteve, teksa përcaktojnë transferimin si një proces të ndryshëm me promovimin (emërimi në një gjykatë më të lartë apo në një post drejtues brenda sistemit). Ky dallim kushtetues dhe ligjor, duhet të jetë udhërrëfyes i detajimit të rregullave mbi këto procese në aktet nënligjore të KLD-së.

Është e vërtetë që në rast se për një vend vakant në një gjykatë të caktuar aplikojnë me vullnetin e tyre të lirë, gjyqtarë që ushtrojnë funksionin në një gjykatë tjetër, kriter përcaktues në vendimmarrje duhet të jetë performanca dhe eksperiencia profesionale, kriter këto që janë përcaktuese edhe në rastin e promovimit. Megjithatë, ky rast nuk duhet të shihet si promovim, por si një transferim, me pëlqimin e vetë gjyqtarit. Konfondimi i dy procedurave, jo vetëm nuk i përgjigjet dallimit që vendos Kushtetuta dhe ligji, por rrezikon të kthejë vendimmarrjet përkatëse të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në vendimmarrje antikushtetuese dhe antiligjore.

IV. Përfundime dhe rekomandime

Duke qenë se promovimi dhe transferimi i gjyqtarëve përbëjnë tregues të funksionimit të sistemit gjyqësor në një shtet dhe kanë impakt të drejtpërdrejtë tek profesionalizmi dhe efektiviteti në dhënien e drejtësisë, është e rëndësishme për një shtet të ketë vazhdimisht në vëmendje vlerësimin dhe përsosjen e sistemit të promovimit dhe transferimit të gjyqtarëve dhe të përpiqet të maksimalizojë efektivitetin në zbatimin e kuadrit ligjor përkatës. Në këtë kontekst, evidentimi i problematikave aktuale, përbën hapin kryesor në përpjekjet për përmirësimin e sistemit. Analiza e paraqitur në këtë dokumentnxjerr përfundimet dhe rekomandimet e mëposhtme, të përvijuara sipas dy çështjeve kryesore të marra në analizë: promovimit dhe transferimit:

- Promovimi

Është lehtësisht e evidentueshme që në rastin e Shqipërisë, sistemi aktual i parashikuar për promovimin e gjyqtarëve përbën progres krahasuar me sistemin e mëparshëm të shfuqizuar.

Aktualisht është kaluar nga një sistem me rregulla të pakta të përcaktuara vetëm në ligjin nr. 8436, datë 28.12.1998 dhe me mungesë të rregullimit të posaçëm mbi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale dhe cilësive të larta etiko-morale të gjyqtarëve që përbënte premisë për promovime të bëra pa procedura të qarta, mbi vlerësime subjektive dhe jotransparente, në një sistem, të vendosur nga ligji nr. 9877/2008, i cili jo vetëm ka shtuar kriteret lidhur me promovimin e gjyqtarëve, por edhe ka deleguar aspekte të veçanta të promovimit në akte nënligjore të KLD-së. Plotësimi i kuadrit ligjor ekzistues me vendimin e KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve” dhe Vendimin e datës 27.09.2010 “Për rregullat e hollësishme për sistemin e pikëzimit të detyrueshëm për zbatim, në rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për plotësimin e vendeve vakante në gjykatat e apelit dhe gjykatat për krime të rënda”, me siguri përbën një hap pozitiv drejt përmirësimit të sistemit të promovimit të gjyqtarëve, duke garantuar vlerësimin e komponentëve esenciale për ecurinë në karrierë brenda gjyqësorit. Megjithatë, sistemi ende shfaq problematika, adresimi i të cilave përbën domosdoshmëri për konsolidimin e vlerave të tilla si profesionalizmi, efektiviteti në ushtrimin e detyrës dhe zbatimin e parimit të meritokracisë, me qëllimin final të konsolidimit të sistemit gjyqësor.

Konkretisht, përbën domosdoshmëri adresimi i problematikës që shfaq sistemi i pikëzimit në lidhje me raportin e vendosur prej tij midis kriterit të vjetërsisë në profesion dhe kriterit të rezultateve të punës në vijimësi. Duke konsideruar rezultatet e punës në vijimësi si një kriter të rëndësishëm parësor për promovimin e gjyqtarit, gjë që rrjedh edhe nga vetë fryma e ligjit nr. 9877/2008, duket e domosdoshme ndërhyrja në Vendimin e KLD-së, me qëllim vendosjen e një raporti të tillë midis kriterit “vjetërsi në profesion” dhe kriterit “rezultate të punës në vijimësi”, ku t’i jepet më tepër peshë kriterit të “rezultateve të punës në vijimësi”. Në funksion të përmirësimit të sistemit të pikëzimit e si pasojë, të vetë sistemit të promovimit të gjyqtarëve, zgjidhja me e përshtatshme do të ishte që vitet e vjetërsisë në profesion të ishin determinante vetëm në rastin e përzgjedhjes midis kandidatëve me rezultate të njëjta të punës në vijimësi. Në çdo rast tjetër, sistemi i pikëzimit duhet të sigurojë që rezultatet e punës të jenë përcaktuese në vendimmarrjen për promovimin e një gjyqtari.

Një ndryshim i tillë në vendimin e KLD-së mbi sistemin e pikëzimit, bën të domosdoshëm edhe qartësimin e shkronjës “b” të pikës 2.1.2 mbi kriterin e rezultateve të punës në vijimësi dhe komponentët e këtij vendimi. Është e rëndësishme që sistemi i pikëzimit t’i përgjigjet kërkesave të ligjit 9877/2008 në mbështetje të të cilit ka dalë edhe vendimi për miratimin e këtij sistemi e për pasojë, të mos referojë vetëm tek rezultati i një vlerësimi të vetëm por tek vijimësia e rezultateve si dhe të garantojë vlerësimin efektiv të kësaj vijimësie duke siguruar mekanizmin e duhur për matjen e rezultateve të vlerësimeve të shtrira në kohë. Adresimi i mangësive në përcaktimet e sistemit të pikëzimit mbi këtë kriter, duhet të sigurojë lidhjen e nevojshme të rezultateve të punës në vijimësi me listën e përhershme të renditjes së gjyqtarëve, si kërkesë kjo që rrjedh drejtpërdrejt nga ligji 9877/2008. Në këtë kontekst, përbën domosdoshmëri, miratimi sa më parë i vendimit të parashikuar nga neni 14 i ligjit 9877/2008 mbi përcaktimin e kriterëve për renditjen e gjyqtarit në listën e përhershme për rezultatet e punës në vijimësi. Miratimi i këtij akti është esenciale jo vetëm për të bërë të zbatueshëm në praktikë sistemin e pikëzimit, por për ta bërë atë të zbatueshëm në përputhje me ligjin nr. 9877/2008.

Parashikimi në ligj i një kriteri të tillë si ai i veprimtarisë shkencore dhe akademike dhe zbërthimi i këtij kriteri në komponentë konkrete mbi të cilët mbështetet vlerësimi, përbën pa

dyschim, një aspekt pozitiv të sistemit të ri të promovimit të gjyqtarëve. Një kriter i tillë, jo vetëm që siguron ngritjen në karrierë të gjyqtarëve me kontribut konkret në jetën akademike dhe shkencore, në fushën e së drejtës si garanci kjo për një nivel të lartë kompetencash personale dhe profesionale, por shërben gjithashtu edhe si nxitje për gjyqtarët për angazhimin e tyre në veprimtari shkencore dhe akademike dhe për përmirësimin e tyre të vazhdueshëm. Megjithatë, është e nevojshme që ky kriter të zërthehet në komponentë të përshtatshëm, që i përgjigjen konceptit të veprimtarisë shkencore dhe akademike. Në këtë kuadër, sistemi aktual i pikëzimit duhet të ndryshojë duke shmangur vlerësimin e gjyqtarit nën suazën e këtij kriteri, për veprimtari profesionale (si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, gjyqtar i Gjykatës së Lartë, anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë) dhe të përfshijë eksperiencën akademike, në përmasën e të qenit pedagog në institucione të tilla të arsimit të lartë si fakultete drejtësie apo Shkolla e Magjistraturës.

- **Transferimi**

Sa i takon sistemit të transferimit të gjyqtarëve është e domosdoshme që ky sistem t'i përgjigjet kërkesave për transparencë. Nga analiza e mësipërme, arrihet në përfundimin se përveç parashikimit në Kushtetutë dhe në ligjin 9877/2008 të një rregulli të përgjithshëm mbi transferimet, mungojnë kritere të qarta, të mirëpërcaktuara dhe transparente mbi transferimin e gjyqtarëve. Kjo ka çuar në situata të tilla ku transferimet mbështeten në subjektivizmin e KLD-së. Gjithashtu, vihen re problematika në lidhje me perceptimin e nocionit të "riorganizimit të gjyqësorit", të cilat kanë çuar deri dhe në zbatimin nga KLD-së, të kriterëve të ndryshme mbi këtë nocion dhe në transferime preferenciale.

Rrjedhimisht, është e domosdoshme që ligji të përcaktojë rregulla të detajuara mbi transferimin e gjyqtarëve me pëlqimin e tyre, ashtu edhe për transferimin e gjyqtarëve për shkak të nevojave të riorganizimit të sistemit gjyqësor, duke shmangur çdo mundësi për aplikimin e procedurave jo transparente dhe për vendimmarrje subjektive të KLD-së. Në këtë kontekst, është e nevojshme të përkufizohet qartë edhe koncepti i riorganizimit të gjyqësorit në mënyrë që të jetë e qartë procedura e transferimit që duhet të ndiqet për çdo rast.

Në praktikë, vihet re një konfondim midis transferimit dhe promovimit, duke konsideruar rastet e transferimit në gjykata të tilla si ato të rretheve gjyqësore Tiranë e Durrës, si promovim. Baza për krijimin e një perceptimi të tillë qëndron pikërisht tek Vendimi i KLD-së nr. 216, datë 28.09.2007 që cilëson këto gjykata si "gjykata karriere" që shërbejnë për promovimin e gjyqtarëve. Një përcaktim i tillë me vendim KLD-je, në mungesë të një kuptimi kushtetues apo ligjor të nocionit "gjykatë karriere" dhe në mungesë të mbështetjes ligjore për një përcaktim të tillë, ngre çështje kushtetutshmërie. Në funksion efektivitetit të zbatimit të procedurave të transferimit dhe moskonfondimit të tyre me promovimin, si dhe për të shmangur diskriminimin midis gjykatave të të njëjtit nivel, është e nevojshme që të shmangen përcaktime të tilla.

Në këtë kuadër, për shmangien e problematikave të procesit të promovimit dhe të transferimit të gjyqtarëve, sipas rekomandimeve të sqaruara në këtë dokument, është i nevojshëm:

A. Ndryshimi i Vendimit të KLD-së i datës 27.09.2010 "Për rregullat e hollësishme për sistemin e pikëzimit të detyrueshëm për zbatim, në rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për plotësimin e vendeve vakante në gjykatat e apelit dhe gjykatat për krime të rënda";

B. Miratimi i Vendimit të KLD-së, i parashikuar nga neni 14 i ligjit 9877/2008 mbi përcaktimin e kriterëve për renditjen e gjyqtarit në listën e përhershme për rezultatet e punës në vijimësi;

C. Miratimi i shtesave në ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe i ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, i ndryshuar, në lidhje me transferimet;

D. Shfuqizimi i përcaktimit të gjykatave të rretheve gjyqësore Tiranë e Durrës si ‘gjykata karriere’.